



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**Tiranë, më 18.04.2018, ora 9:30**

**Drejton mbledhjen:**

**Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:** Diskutim për kalendarin e dëgjësave për shqyrtimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, *komision përgjegjës*.

**Marrin pjesë:**

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro.

**Mungojnë:**

Enada Kapllani.

## HAPET MBLEDHJA

**Milva Ekonomi** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Do ta zhvillojmë këtë mbledhje të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për të caktuar kalendarin e punës për projektligjin “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, që është depozituar në Kuvend nga një grup deputetësh.

Përpara kemi një draftkalendar të përgatitur nga zoti Bela, të cilin mund ta shikoni dhe pastaj të vendosim për datat. Zoti Bela propozon datën 6 maj për të filluar punën për këtë projektligj, por mbrëmë, pas orës 23:30, më është caktuar një detyrë dhe në datat 5 dhe 6 maj do të jem në një mbledhje jashtë vendit. Mbase mund ta bëjmë dëgjuesën e parë në datën 3 maj, ditën e premte, apo do ta shtyjmë pas datës 7 maj?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ka njeri tjetër që duhet të lëvizë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Shikoni kalendarin, sepse u spostua.

**Mirela Kumbaro** – Në cilën datë e spostuat?

E keni pare që këtu thuhet që është me propozim të Këshillit të Ministrave?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Gazmend Bici** – Është e një grupi deputetësh....

**Milva Ekonomi** - Nuk kemi çfarë t’i bëjmë, sepse ashtu ka ardhur. Do të marrë komente kjo gjë.

**Fidel Ylli** – Unë mendoj që seancën dëgjimore me rektorët e universiteteve private duhet ta bëjmë në të njëjtën orë, në datën 20 maj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Vilma Bello** – Të dyja private janë. Mund të bëhen në një ditë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Mund ta bëjmë dëgjuesën e parë në datën 10 maj? Nuk kam zgjidhje tjetër, sepse në datën 7 do të jem në udhëtim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fadil Nasufi** – Me këtë që shohim në projektkalendarin që na është vënë përpara, planifikohen 6 sanca dëgjimore.

**Fidel Ylli** – Mund ta bëjmë edhe pasdite, të hënën, martën apo mërkurën.

**Milva Ekonomi** – A mund ta bëjmë diskutimin në parim në datën 3 maj, të premten?

**Fidel Ylli** – Milva, pse nuk i bëjmë paradite dhe pasdite?

**Milva Ekonomi** – I bëjmë, por duhet të caktojmë datën e parë për të thirrur depozituesit.

**Ismet Beqiraj** – Ju kur keni datë të lirë për seancën e parë?

**Milva Ekonomi** – Në datën 3 unë jam e gatshme, por është e premtë. Unë iki në datën 5 dhe kthehem në datën 8.

**Ismet Beqiraj** – Ditën e premtë ne fillojmë me fushatën në terren ...

**Milva Ekonomi** – Nuk ka nisur akoma. Fushata është e dyta, kurse detyra është e para.

**Ismet Beqiraj** – Por unë shkoj në Mallakastër të premtën!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Dakord, edhe po të mos vini ju të premtën, ne bëhemi 7 deputetë të pranishëm dhe mund ta zhvillojmë mbledhjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ismet Beqiraj** – Ditën e premtë unë e kam të angazhuar në zonë.

**Fidel Ylli** – Unë jam dakord me Ismetin. Ditët e premtë ne duhet t'i kemi të lira, që të shkojmë në zonat tona elektorale.

**Milva Ekonomi** – Po kush jua ka zënë juve të premtën?! Askush nuk ju ka thirrur në mbledhje ditët e premtë. Unë po jua shpjegoj rastin për një të premtë, sepse është një rast special.

**Ismet Beqiraj** – po punë e madhe, e bëjmë të hënën dëgjuesën.

**Vilma Bello** – Nuk është kryetarja, pra!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E rrisojmë një të premtë.

**Muhamet Bela** – Nuk mund të bëhet mbledhja e komisionit, pa qenë drejtuesi i Komisionit.

**Milva Ekonomi** – Shkon shumë gjatë. Duhet ta hapim dëgjuesën, kurse pastaj le të marrë kohë.

Data 10 bie përsëri e premtë, në datën 8 ka seancë plenare, kurse në datën 9 është dita e Europës dhe kemi aktivitete të tjera. Data 10 është një mundësi, në datat 13-14 maj do të jemi në Kosovë, sepse e kemi marrë përsipër që do të shkojmë, kështu që hapja e dëgjuesës së parë ngelet për në datën 15 maj. Doni datën 15 maj apo datën 3 maj?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Muhamed, ju lutem, pyesni disa nga nismëtarët nëse janë prezentë në Shqipëri në datën 15 maj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fidel Ylli** –Po data 8, pse është vënë këtu?

**Milva Ekonomi** - Është bërë gabim, pra, sepse në datën 8 ka seancë plenare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të gjitha do të spostohen.

Shikoni kur mund të bëjmë dy aktivitete në një ditë dhe ta japim propozimin tani, sepse çështja e datave u mbyll.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ditën e hënë, në datën 15, do të bëhet dëgjesa pas orës 11: 00, kurse ditën e martë do të bëhen të tria dëgjesat: me Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike dhe me akademikun Artan Fuga.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ismet Beqiraj** – Ka shprehur interes si grup interesi të jetë i pranishëm me grupin e tij edhe akademiku Dhimitër Haxhimihali.

**Milva Ekonomi** – Ta shikojmë se ku mund ta fusim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Gazmend Bici** - ... mendoj që afër kësaj date duhet të caktohen edhe data të tjera për aktorët e interesit. Gjërat mund të ndryshojnë, se jemi një muaj në avancë, prandaj mendoj se jemi shumë herët për të caktuar datat për grupet e interesit.

**Milva Ekonomi** – Unë mendoj që të nesërmen e datës 15, parimisht, të mblidhen të tri grupet e interesit, pra t’i dëgjojmë njëri pas tjetrit.

Do të jetë më vete seanca dëgjimore me Ministrinë e Arsimit?

**Gazmend Bici** – Jo, diskutimi në parim bëhet gjithmonë në prani të ...

**Milva Ekonomi** – Do të kemi seancë dëgjimore të veçantë me Ministrinë?

**Gazmend Bici** – Jo.

**Milva Ekonomi** – Po pse e kemi vendosur këtu?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Muhamet Bela** – E vendosa me qëllimin e mirë që....

**Milva Ekonomi** - Dakord, e kuptojmë qëllimin e mirë.

Kemi seancë dëgjimore me dekanët. I kemi ndarë në pesë ditë

**Mirela Kumbaro** – Ka mundësi që të mos jem në datat 13 dhe 14.

**Milva Ekonomi** - T’i mbledhim seancat, siç bëjmë kur miratojmë ligjin e buxhetit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Këta të tre do t’i mbledhim në një ditë, kurse universitetet do t’i mbledhim në tri ditë, maksimalisht.

**Muhamet Bela** – Mendoj të ftoj më vetëm rektorët dhe jo dekanët.

**Milva Ekonomi** – Lindita, si mendoni ju, rektorët dhe dekanët apo vetëm rektorët?

**Lindita Nikolla** – Vetëm rektorët.

**Milva Ekonomi** – Dakord.

**Gazmend Bici** - Meqë është nismë deputetësh, mendoj se që në mbledhjen e parë, pas diskutimit në parim, pra nëse miratohet në parim, duhet t'i dërgohet për mendim Këshillit të Ministrave, sepse pavarësisht se projektligji thotë se nuk ka efekte financiare, është KM-ja që vlerëson nëse ka apo jo efekte financiare. Kështu, normalisht, KM-ja mund të shprehet brenda kohës që e gjykon të nevojshme.

**Milva Ekonomi** – Ky është një kusht?

**Muhamet Bela** – Po, patjetër. Ky është një detyrim kushtetues.

**Milva Ekonomi** – Dakord.

**Ismet Beqiraj** – Po, patjetër! E vlerëson Këshilli i Ministrave.

**Milva Ekonomi** – Dakord, këtë do ta bëjmë që të kapim kohën. Atëherë, në një ditë kemi akademitë dhe në 3 ditë kemi universitetet. A ka grupe të tjera interesi?

**Ismet Beqiraj** – Po, kjo që propozova unë.

**Milva Ekonomi** – Kjo do të hyjë te pjesa e ditës së parë...

**Muhamet Bela** – Kam edhe unë diçka në lidhje me propozimin e Ismetit. Ka personalitete të fushës, që kanë dalë në pension, që kërkojnë të dëgohen. Bie fjala, ka disa personalitete që i njoh edhe unë personalisht që kërkojnë të dëgohen.

**Milva Ekonomi** – Dakord, një ditë do të dëgjojmë grupet e interesit, një ditë tjetër do të kemi Akademinë e Shkencave, 3 ditë i kemi lënë për universitetet dhe një ditë e kemi përsëri me grupet e interesit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Po, do të shohim listën e grupeve.

**Fidel Ylli** – Po e hapëm lojën duke dëgjuar individët, nuk mbarojmë dot kurrë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fadil Nasufi** – Kështu do të hapet shumë loja. Është Luan Omari, që është mjeshtri i të gjithë botës akademike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, do të caktosh seanca me persona të veçantë apo do t'i vësh me grupet e interesit?

E dyta, unë isha në kafe me Shaban Sinanin dhe me Vaso Tolen. Ata më thanë se konsulent i ligjit ka qenë një specialist gjerman dhe se është mirë që ta thërrasim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Lindita, si mendon, a do të harxhojmë pak kohë me grupet e interesit?

**Lindita Nikolla** - Nuk ia vlen. Të gjithë këta persona që futen te grupet e interesit, janë akademikë. Luan Omari është akademik. Ne do t'i ftojme përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave. Nuk ke pse t'i ndash veç si institucione dhe veç si persona.

**Ismet Beqiraj** – Atëherë, pse është futur Fuga me grupin alternativ? Ai është alternativ në medie, është anëtar i Akademisë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Pse e diferencojmë profesor Fugën?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ai ka qenë në top-listën e atyre që kanë bërë ligjin për akademinë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ai ka qenë në dhjetëshen e përzgjedhur dhe tani ashtu e bën ligjin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Milva Ekonomi** – Ke të drejtë. Le të dëgjojmë arsyen pse e kemi thirrur.

**Ismet Beqiraj** – Pse është futur prof. Fuga me grupin alternativ? Ai thotë se është në grupin alternativ. Konkretisht, ky akademik, që është në nder të shkencës shqiptare, nuk është nga ata që rrinë në portalet ditën për të bërë llafe dhe bëhen specialistë.

**Lindita Nikolla** – A është anëtar i akademisë ai?

**Ismet Beqiraj** – Jo, ai ka dalë në pension tani. Nuk e di. Më duket se i ka mbaruar mandati.

*(Ndërhyrje pa mikrofon,)*

**Lindita Nikolla** – Një sekondë, sa të sqaroj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Meqenëse jam në dijeni të këtij procesi, po e sqaroj. Në momentin që Kryeministri kërkoi një rithemelim të Akademisë së Shkencave, u ngrit një grup me përfaqësi akademike, kryetar i të cilit ishte Skënder Gjinushi, i cili ka prodhuar një dokument që ka gjasa të jetë dokumenti që na përcillet nga deputetët.

Gjatë gjithë kësaj situatë, këtyre procedurave, Fuga ka qenë kundër dhe ka pasur një komunikim me Kryeministrin, duke thënë se produkti që vjen nga komisioni, nuk është gjë tjetër veçse një arnim i ligjit të mëparshëm për Akademinë e Shkencave. Kryeministri e ka ftuar që ai të mos shprehë thjesht kritika, por të japë produktin e vet. Më pas, ai ka punuar dhe ka nxjerrë një draftligj alternativ për Akademinë e Shkencave. Kryeministri ka kërkuar të

debatohen në publik të dyja platformat, edhe platforma që vinte nga zoti Gjinushi, edhe platforma e zotit Fuga.

Gjatë kohës që unë kam qenë krye të detyrës në Ministrinë e Arsimit, kemi marrë opinione nga përfaqësuesit e departamenteve, nga universitetet dhe kemi kërkuar edhe opinionin e Komisionit European për të dyja platformat. Di që janë kthyer komentet edhe nga universitetet, edhe nga Komisioni European për këtë çështje. Aty u la. Ne kërkuam të ketë një ballafaqim të madh publik për të dyja këto platforma, duke u ngritur një juri përfaqësuese edhe me akademikët nga Kosova, edhe me arbëreshët e me radhë, por për shkak të situatës që ndodhi, protestave studentore, ky proces mbeti përgjysmë. Njëra prej alternativave (nuk e di, se nuk e kam parë atë, por kërkoj ndjesë nëse gaboj), alternativa e prodhuar nga komisioni akademik, që për hir të së vërtetës është votuar nga asambleja me një votë kundër, vetëm nga Artan Fuga, vjen nga deputetët. Kështu, ne nuk mund ta anashkalojmë atë, sepse ajo ishte futur në procesin e diskutimit. Edhe IAL-ve u janë çuar të dyja platformat, A dhe B, pa u treguar se cila është e njërit dhe cila është e tjetrit, në mënyrë që IAL-të të shprehin lirshëm idetë e tyre. Kjo është situata.

**Milva Ekonomi** – Dakord.

**Ismet Beqiraj** – Zonja Lindita, edhe gjatë diskutimit të projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, kemi bërë dëgjesa. Ne nuk i kemi shmangur ato.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Kur i kemi futur, gjatë diskutimit të projektligjit?

**Ismet Beqiraj** – I kemi futur sa jemi lodhur.

**Milva Ekonomi** – Jo, gjatë diskutimit, se ne e kishim qëndisur atë fazë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk futëm dëgjesa gjatë diskutimit të projektligjit.

**Fidel Ylli** – Kemi futur institucionet, jo individë te grupet e interesit.

Ne ramë dakord për listën e grupeve të interesit dhe e miratuam atë.

**Ismet Beqiraj** – Edhe ky është një grup interesi, që po e shpreh alternativën e tij.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

T’i bashkohet ose grupit të Gjinushit, ose grupit tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Ismet, mos e ndërliko tani. Ai më ka dërguar mua një kërkesë me *What’s up* në mënyrë institucionale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dhimitër Haxhimihali ka dërguar një kërkesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dikush i ka dhënë numrin tim dhe ai ma ka dërguar mua .

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në mënyrë institucionale duhej t'i ishte dërguar sekretarisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk është ky problemi në këtë rast.

**Bujar Çela** – A na ndihmon me ndonjë gjë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk mund të përgjigjem saktë.

**Ismet Beqiraj** – E ndihmon çështjen.

**Milva Ekonomi** – Përveç kësaj unë desha edhe diçka nga stafi i komisionit. Siç e bëmë te ligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, që çdo koment e zbardhëm, duke e vendosur në folder-in e komenteve, kështu ta bëjmë edhe për këtë ligj.

**Muhamet Bela** – Atë e kemi për detyrë.

**Milva Ekonomi** – Mbi atë folder punuam në fund, atë e përdorëm si material pune. Siç punuam me aq kujdes për atë ligj, ju ftoj që po ashtu të punojmë me po aq kujdes edhe për këtë ligj.

Se si do ta zgjidhim kërkesën e Dhimitër Haxhimihalit, këtë do ta shohim. Ndërkohë, ramë dakord që një ditë do të bëjmë dëgjesën me Akademinë dhe për 3 ditë do të bëjmë dëgjesat me universitetet. Për grupet e tjera do ta shohim se si do ta zgjidhim bashkë.

Diskutimet do të fillojnë më datë 15 maj.

Jeni dakord? Në rregull.

Atëherë, e mbyllim mbledhjen dhe kthehemi në sallë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, më 15 maj.

Faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**



